



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS KAMENICË

Numri i lëndës: 2022:124241

Datë: 19.07.2024

Numri i dokumentit: 05960816

C.nr.165/2022

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, gjyqtari Valbonë Dërvodeli, me bashkëpunëtorin profesional Blerand Sopi, në çështjen kontestimore të paditësit Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë-Ministra e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, me adresë Rr.Ukshin Hoti, 10000 Prishtinë, kundër të paditurit B. H., nga, tani me adresë të panjohur, me objekt, padi për kthim të mjeteve financiare për shkak të mos përmbushjes së kontratës, me vlerë të kontestit 29,991.36 euro, jashtë seance gjyqësore, më datë 19.07.2024 mori këtë:

A K T V E N D I M

HEDHET POSHTË PADIA e paditësit Byro Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë-Ministra e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, e parashtruar kundër të paditurit B. H., nga, tani me adresë të panjohur, me objekt kontesti padi për kthim të mjeteve financiare për shkak të mos përmbushjes së kontratës, me vlerë të kontestit 29,991.36 euro.

A r s y e t i m

Paditësi, më datë 17.06.2022 ka paraqitur padi në këtë gjykatë kundër të paditurit të lartëshënuar, për kthim të mjeteve financiare për shkak të mos përmbushjes së kontratës, me vlerë të kontestit 29,991.36 euro.

Gjykata, për shkak të adresës së panjohur të të paditurit, me aktvendimin e kësaj lënde të datës 27.05.2024 ka detyruar paditësin të plotësojë padinë, duke deponuar shumën prej 509.60 euro, në emër të paradhënies për shpërblimin e punës së përfaqësuesit të përkohshëm, edhe atë në afat prej 15 ditë, nga dita e pranimit të aktvendimit, nën pasojat se do të hedhet poshtë padia nëse nuk vepron sipas këtij detyrimi.

Përfaqësuesi i paditësit, me datë 04.06.2024 e ka pranuar Aktvendimin e C.nr.679/2020 të datës 27.05.2024, mirëpo deri në datën e përpilimit të këtij aktvendimi, nuk ka deponuar shumën sipas aktvendimit të gjykatës, me çka gjykata në pamundësi për të vepruar ndryshe, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Në këtë kuptim, gjykata gjeti se paditësi nuk ka vepruar sipas aktvendimit për plotësim të padisë, edhe pse pasojat procedurale i ka pasur të njohura dhe bazuar në nenin 391 pika g) të LPK-së, vendosi të hedhë poshtë padinë e paditësit si në këtë dispozitiv.

Nga sa u tha më lartë, e në bazë të nenit 142 të LPK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS KAMENICË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL
2022:124241, 19.07.2024**

Gjyqtarja,

Valbonë Dërvodeli, d.v.

UDHËZIMI JURIDIK: Kundër këtij aktvendimi, është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të tij, Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.